



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 982 Prot.

Tiranë, më 5 maj 2016

*Kërkesë - Komunikim i Institucionit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë drejtuar Komitetit për Zbatimin e Konventës së Aarhusit*

**I nderuar zoti Kryetar, Prof. Ebbesson,  
Të nderuar anëtarë të Komitetit për Zbatimin e Konventës së Aarhusit,**

Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë ka ndjekur me shqetësim në rritje zhvillimet në lidhje me projektin e ndërtimit, të zbatuar që prej datës 8 shkurt 2016 në brendësi të Parkut të Liqenit të Tiranës, në Shqipëri.

Presidenti i Republikës është i informuar se grupime organizatash joqeveritare, parti politike, dhe aktivistë ambientale kanë nisur procedurat gjyqësore duke përfshirë padi penale dhe administrative kundrejt këtij projekti, i cili sipas tyre shkakton dëme serioze ambientale për kryeqytetin e Shqipërisë, por gjithashtu është dhe në shkeljen të plotë të konventës së Aarhusit, të cilën prej vitesh tashmë e ka nënshkruar dhe Shqipëria. Gjatë takimit me shoqërinë civile dhe aktivistë të mbrojtjes së ambientit të përfshirë në protestat kundër këtij projekti si dhe gjatë vizitës në sheshin e ndërtimit Presidenti i Republikës u informua gjithashtu edhe rreth akteve të dhunës dhe presionit kundrejt protestuesve, si edhe të përdorimit joproporcional të forcës policore, këto të vëna në dukje gjithashtu edhe nga raportet e Avokatit të Popullit të Republikës së Shqipërisë.

Presidenti i Republikës së Shqipërisë është i shqetësuar rreth mundësisë së politizimit të çështjes, keqinterpretimeve si dhe thellimit të problematikës ambientale dhe sociale, gjë e cila mund të dëmtojë cipën e hollë të demokracisë së shoqërisë shqiptare.

Presidenti i Republikës është mjaft i interesuar në kryerjen e një hetimi ndërkombëtar, të pavarur, për këtë çështje, me qëllim, që të mundësohet një diskutim më i hapur, pozitiv, i bazuar mbi fakte dhe gjithëpërfshirës për palët e përfshira.

Për këtë qëllim dhe arsye, i parashtrojmë Komitetit për Zbatimin e Konventës së Aarhusit kërkesën që të mundësojë ekspertizë terreni në Shqipëri, nëpërmjet një eksperti të pavarur, i cili do të kontaktojë të gjitha palët e përfshira.

Institucioni i Presidentit është i gatshëm të mbulojë shpenzimet e nevojshme, udhëtim, akomodim dhe shpenzime të tjera ditore, për një mision të limituar terreni si dhe të furnizojë me informacionet paraprake Komitetin e Zbatimit, të cilat mund të jenë të domosdoshme për të marrë vendimin nëse është ose jo i nevojshëm një mision i tillë.

Duke pasur në vëmendje të dhënat e sipërpërmendura, ne do t'ju luteshim që ky komunikim të procedohet në mënyrë konfidenciale nga ana e Komitetit!

Institucioni i Presidentit është tepër i interesuar rreth sugjerimeve tuaja për ta adresuar këtë çështje, bashkë me Komitetin, drejt interesit më të mirë për Shqipërinë dhe në zbatim të plotë të Konventës së Aarhusit, duke marrë parasysh rëndësinë e rastit dhe veçoritë e palëve të përfshira.

Shpresojmë në një komunikim të hapur e shkëmbim efektiv dhe produktiv idesh me Komitetin rreth kësaj çështje me rëndësi të veçantë,

Sinqerisht,

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**  
  
**FLORJAN NURI**

---

**Z. Jonas EBBESSON**

**Kryetar i Komisionit të Përputhshmërisë së Konventës së Aarhusit 2014-2017**

**Sekretariatit të Konventës së Aarhusit**

**Departamentit të Komisionit Ekonomik të Organizatës së Kombeve të**

**Bashkuara për Mjedisin dhe Ndërmjetësimin Njerëzor**

**Dhoma 332, Pallati i Kombeve, Gjenevë,**

**ZVICËR**